



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 5, datë 12/03/2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES "PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJITIK",
SHOQËRISË "KROI MBRET ENERGJI" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2. nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes "Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik", shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., me vendndodhje, njësia administrative Potom, Bashkia Skrapar, Qarku Berat, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak për këtë fazë janë si më poshtë:

HEC Backa A

Vepra e marrjes nr. A/1

- X=536435.545
- Y=4487174.184

- $Z=1595.8$ m.m.n.d

Vepra e marrjes nr. A/2

- $X=535424.745$
- $Y=4487627.784$
- $Z=1595$ m.m.n.d

Godina e Centralit

- $X=534411.145$
- $Y=4484970.584$
- $Z=960$ m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.087$ m³/s
- $Q_{llog}=0.25$ m³/s
- $Q_{eko}=0.074$ m³/s
- Fuqia e instaluar $N=1347$ Kw
- Energjia Vjetore $E=4058827$ Kw/vit

HEC Backa C

Vepra e marrjes nr. C/1

- $X=534357.945$
- $Y=4484757.356$
- $Z=952.9$ m.m.n.d

Vepra e marrjes nr. C/2

- $X=535259.678$
- $Y=4484757.356$
- $Z=969$ m.m.n.d

Vepra e marrjes nr. C/3

- $X=535273.545$
- $Y=4483584.584$
- $Z=985$ m.m.n.d

Godina e Centralit

- $X=532950.578$
- $Y=4483243.970$
- $Z=701.5$ m.m.n.d

- Qmes=0.478m³/s
- Qllog=0.9m³/s
- Qeko=0.002m³/s
- Fuqia e instaluar N=1910 Kw
- Energjia Vjetore E=4935624 Kw/vit

HEC Backa 1

Vepra e marrjes nr.1

- X=532911.378
- Y=4483157.170
- Z=703 m.m.n.d

Godina e Centralit

- X=531273.378
- Y=4479560.570
- Z=450 m.m.n.d
- Qmes=0.82m³/s
- Qllog=1.6m³/s
- Qeko=0.042m³/s
- Fuqia e instaluar N=3366 Kw
- Energjia Vjetore E=8860159 Kw/vit

3. Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU SEMAN

BAKI BALA

